



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 353 Akti

Nr. 370 Vendimi
Tiranë, më 22.4.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Suela Zhegu	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datën 22.4.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Dhurata Bilo**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Bilo, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më 12.11.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 18.11.2019 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues z. Olsi Komici. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Elka Ermenkova. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Në datën 15.2.2021 subjekti u njoftua për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ dhe rezultatet paraprake të këtij hetimi.

3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe neni 30 i këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).

5. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar burimin financiar për krijimin e pasurive;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

6. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar² ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2018.

² Me shkresën nr. **** prot., datë 30.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së, deklasifikuar me vendimin nr. *, datë 8.1.2019, të KDZH-së.

organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar.

7. Këshilli i Lartë i Gjyqësor³ ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

8. Në vijim, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 15.2.2021, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht, duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, znj. Dhurata Bilo, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, rezultatet paraprake të hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

10. Znj. Dhurata Bilo, për një proces të rregullt ligjor, i janë garantuar të drejtat si: të njoftohet për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërjen e trupit gjykues; si dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet e hetimit. Në datën 15.2.2021, subjektit iu dërguan rezultatet paraprake të hetimit administrativ dhe iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

11. Subjekti i rivlerësimit Dhurata Bilo, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat në datën 25.2.2021. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se nuk është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit, në datën 25.2.2021, ka depozituar një kërkesë për rihapjen e hetimit dhe vlerësimin për 2 kriteret e tjera, të figurës dhe vlerësimin profesional. Komisioni, pasi e mori në shqyrtim datë 2.3.2021, vendosi të mos e pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit me arsyetimin se provat e grumbulluara deri në atë moment kishin nivelin e provueshmërisë, e parashikuar kjo në pikën 2, të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Trupi gjykues ka argumentuar se në çdo rast, procesi i rivlerësimit në bazë të ligjit fillon njëkohësisht për të tria kriteret e vlerësimit. Komisioni vlerësoi se provat e administruara deri në atë fazë të procesit, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kishin arritur nivelin e provueshmërisë dhe ishin të mjaftueshme për përfundimin e procesit administrativ bazuar vetëm mbi këtë kriter në përputhje me pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

12. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2019, dërgohet raporti i KLP-së.

13. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e kryer elektronikisht në datën 17.3.2021. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 19.4.2021, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Elka Ermenkova.

14. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancën dëgjimore dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit.

15. Në vijim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit nuk pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe, në përfundim, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit, z. Dhurata Bilo, ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, znj. Dhurata Bilo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

18. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;

- b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e. raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGj-ja;
- g. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, mundësinë për fshehje të pasurisë, deklaratim të rremë apo konfliktin e interesit.

Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga znj. Dhurata Bilo në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, konkretisht:

1. Apartament banimi⁴ (4+1) dhe ambiente ndihmëse, lagjja nr. **, Durrës

Vlera e dekluarar: 8.973 lekë + 47.000 lekë.

Pjesa në përqindje: zotëron 25%.

Burimi i krijimit: përfituar nga ligji nr. 7652, datë 30.12.1992, “Mbi privatizimin e banesave shtetërore”.

1.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ASHK-ja Durrës⁵ ka konfirmuar se znj. Dhurata Bilo ka të regjistruar në bashkëpronësi pasurinë apartament me sip. 67.02 m², përfituar nga privatizimi, ndodhur në Durrës, në pronësi të shtetasve Q, Dhurata, Sh dhe A. B.

1.2 Analiza e fakteve

Nga dokumentacioni i ardhur nga ZVRPP-ja Durrës, rezulton një kontratë për privatizimin e banesës shtetërore të datës 30.8.1993, ndërmjet Ndërmarrje Komonale Banesa dhe shtetasve Q.B për pasurinë apartament me sip. 67 m², rruga “K.K”, p. *, shk. *, k. *, e përbërë nga 2 dhoma e 1 kuzhinë.

Në deklaratimin e parë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar pasuri 4+1 dhe ambiente të tjera ndihmëse, zotëruese në masën 25%, përfituar nga ligji nr. 7612, datë 30.12.1992, “Mbi privatizimin e banesave shtetërore”.

⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetim hipotekor nr. ***, datë 31.8.1993, në emër të shtetasve Q, Dhurata, Sh dhe A. B, për apartament 2+1 dhe ambient ndihmës, me sip. 67.02 m², ndodhur në Durrës; hartë treguese; kontratë shitblerje datë 31.8.1993 midis Ndërmarrjes Komonale dhe shtetasve Q, Dhurata, Sh dhe A.B, për apartament me sip. 67.02 m², në vlerën 8.973 lekë; vërtetim nr. ***, datë 31.8.1993, nga Hipoteka Durrës; kontratë nr. ****, datë 22.8.1996; leje ndërtimi nga KRRT-ja Durrës, datë 19.8.1996, për shtesë pallati; mandatarkëtimi nr.**, datë 17.9.2010, ku znj. Dhurata Bilo ka paguar shumën 4.300 lekë për shërbime ALUIZNI. Formular i tarifës së legalizimit në emër të znj. Dhurata Bilo.

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 6.3.2020.

Subjekti ka shpjeguar se⁶: “Sa i përket shtesës anësore në pasurinë me adresë lagjja nr. **, rruga ‘K.K’, p. nr. ***, k. *, Durrës, kjo shtesë, nuk është ndërtuar nga ana jonë (nga familja ime), pavarësisht miratimit të lejes së ndërtimit të dhënë nga KRRT-ja Durrës, me vendim nr. *, datë 30.7.1996, me objekt ‘shtesë anësore pallati nr. **’, si dhe kontratës nr. *** rep., datë 22.8.1996, midis banorëve të pallatit dhe firmës së ndërtimit ‘LL’.

Ju bëj me dije se kjo shtesë është ndërtuar vetëm nga 3 familjet e tjera poshtë nesh, përkatësisht kati 1, kati i 2-të dhe kati i 3-të. Pas largimit, fillimisht, të vëllezërve drejt Italisë dhe më pas të nënës, në këtë banesë, nuk ka banuar më askush. Ky ka qenë shkaku që shtesa nuk u ndërtua”.

Subjekti ka deklaruar në vitet 2003 dhe 2017 si apartament 4+1 dhe ambiente ndihmëse.

Në dosje rezultojnë një kontratë e datës 22.8.1998, e nënshkruar nga 4 qytetarë, ndërmjet tyre edhe shtetasi A. B, me sipërmarrës A.S për kryerjen e punimeve të ndërtimit në banesën nr. ***, Durrës. Bashkëlidhur ndodhet edhe leja e ndërtimit, e vitit 1996.

Bashkëlidhur dokumenteve të kësaj pasurie është një formular i pagesës së tarifës së shërbimit për legalizim, nënshkruar nga znj. Dhurata Bilo, si dhe mandatarëkëtimi nr. **, i datës 17.9.2010, me përshkrimin “shtesë pallati kati IV, u arkëtua nga znj. Dhurata B. Bilo, shuma prej 4.300 lekësh, për shërbime ALUIZNI”.

Për këtë pasuri u konstatua se deklaratimet e subjektit nuk përputhen me aktet ligjore në lidhje me sipërfaqen e apartamentit, pasi subjekti e ka deklaruar 4+1, ndërkohë që nga provat e administruara në dosje rezultojnë të jetë 2+1.

Në lidhje me këtë mospërputhje, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime, si dhe të depozitonte foto të apartamentit ku të evidentohet se nuk ka shtesë anësore, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Kushtetutës.

1.3 Qëndrimi i subjektit

Subjekti, në prapësime, ka shpjeguar se shtesa është bërë në pallat në 3 katet poshtë apartamentit të saj. Pagesa e bërë nga subjekti pranë ALUIZNI-t në vlerën 4.300 lekë në vitin 2010, me porosi të vëllezërve të saj, të cilët i kanë kërkuar për ta bërë pasi kanë pasur gjithnjë në mendje për ta bërë shtesën, siç provohet edhe nga leja e ndërtimit, si dhe shuma e kredituar në llogarinë e saj që është dërguar nga vëllai A.B dhe bashkëshortja e tij E. K, datë 19.7.2011, ka qenë për këtë qëllim. Megjithatë, duke qenë se ata jetojnë në shtetin italian nuk janë bërë asnjëherë mbarë për ta bërë këtë shtesë.

Subjekti ka depozituar 8 foto të apartamentit, nga ku duket qartë se shtesa nuk është kryer, apartamenti është në katin e fundit të pallatit dhe duket se katet poshtë e kanë përfunduar shtesën.

1.4 Analiza ligjore

Komisioni, pasi mori në shqyrtim shpjegimet dhe dokumentacionin provues të depozituar nga subjekti, krijoi bindjen se në këtë apartament nuk ishte kryer asnjë investim, si dhe shtesë anësore. Mospërputhjet në lidhje me sipërfaqen u vlerësuan nga Komisioni thjesht si pasaktësi në deklaratim, pa ndonjë ndikim negativ në vlerësimin përfundimtar të subjektit.

⁶ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 29.4.2020.

Në **konkluzion**, trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ekzistencën e kësaj pasurie si dhe mënyrën e fitimit të saj.

2. Banesë private⁷ dy kate + kat nënçati, e blerë në vitin 2002, mbi një truall me sip. 154.14 m² dhe me sip. ndërtimi 71.64 m² për secilin kat (nënçatia e shfrytëzueshme), e regjistruar në ZVRPP, e ndodhur në lagjen nr. *, rruga “K”, Durrës.

Vlera e deklaruar: 3.400.000 lekë.

Pjesa në përqindje: zotëron 100%.

Burimi i krijimit: blerë dhe pjesërisht përfituar nga ligji nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”.

Deklarimi në DPV: viti 2003, me kursimet e subjektit dhe kredia.

Mënyra e fitimit: me kontratën nr. ****, datë 22.10.2002, për blerjen e shtëpisë së banimit.

2.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ASHK-ja Durrës⁸ ka konfirmuar se znj. Dhurata Bilo ka të regjistruar në pronësinë e saj pasurinë truall+banesë private, përfituar me kontratë shitjeje nr. ****, datë 22.10.2002, në vlerën 2.000.000 lekë. Bashkëlidhur praktika e plotë.

UKT-ja Durrës⁹ ka informuar se në sistemin e faturimit, në emër të znj. Dhurata Bilo, figuron kontrata nr. ****, lagjja nr. *, rruga “D. B”, Durrës.

⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetim nr. ***, datë 30.12.2002, në emër të znj. Dhurata Bilo, për shtëpi banimi me sip. 154.14 m², sip. ndërtimi 71.64 m², ndodhur në Durrës + harta treguese; kontratë nr. ***, datë 22.10.2002, për shitje të pasurisë së paluajtshme shtëpi banimi, midis shitësit F.B dhe blerësit Dhurata Bilo, për shtëpi banimi me sip. 400 kut, ndodhur në Durrës, në vlerën 2.000.000 lekë, pagesë e cila është likuiduar *cash* në zyrë para noterit; deklaratë noteriale nr. ***, datë 2.10.2003, me huadhënëse F.B dhe huamarrëse Dhurata Bilo, palët kanë lidhur akt noterial nr. ***, datë 22.10.2002, ku znj. F.B i ka dhënë znj. Dhurata Bilo hua në shumën 1.400.000 lekë, me afat kthimi deri më 1.11.2003. Znj. Dhurata Bilo nëpërmjet këtij akti i dorëzon plotësisht shumën prej 1.400.000 lekësh palës F.B duke shlyer detyrimin ndaj saj; kontratë sipërmarrje dhe investim ndërtimor nr. ***, datë 15.4.2003, palë porositore dhe investitore (pronare e vetme e tokës dhe investitorë financiar datë) znj. Dhurata Bilo dhe palë sipërmarrëse (person fizik i licencuar në fushën ndërtimore) Sh. K. Pronarja e truallit, znj. Dhurata Bilo është dakord që me shpenzimet e saj të kryhet mbi sipërfaqen e tokës prej 400 kut një rikonstruksion i plotë me strukturë dhe cilësi punimesh sipas projektit të miratuar nga KRRT-ja Durrës. Në katin e parë të ndërtohen dy dhoma me sip. 80 m², kati i dytë me sip. 80 m² dhe nën çati të bëhet papafingo me sip. 25 m². Afati i përfundimit do të jetë data 15.7.2003. Ky rikonstruksion do të kryhet nga sipërmarrësi në vlerën 3.884.700 lekë, vlerë e cila është parapaguar nga pala investitore + preventiv nga inxh. Sh.K, me vlerën 4.861.000 lekë; vërtetim datë 24.1.2017, nga NBG-ja, ku vërtetohet se znj. Dhurata Bilo ka marrë pranë NBG-së kredi, datë 25.3.2003, në shumën 15.000 USD dhe detyrimi i saj sot është në shumën 1.900 USD. Në datën 10.11.2004 ka marrë kredi në shumën 10.000 USD dhe detyrimi sot është në shumën 2.982 USD; deklaratë noteriale nr. ****, datë 3.4.2003, me deklarues Dhurata Bilo, e cila deklaroi se mbështetur në relacionin e Drejtorisë Qëndrore, mbi VKM-në nr. 153, datë 22.3.2001, “Për procedurat e operimeve financiare”, në zbatim të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, tarifa për 2 dhoma, 1 kuzhinë dhe ambiente ndihmëse është 1.840.820 lekë. Sipas tarifave, vlerësimi për znj. Dhurata Bilo është në vlerën 329.490 lekë, duke i zbritur nga tarifa e miratuar prej 1.840.820 lekësh detyrimin 329.490 lekë, që i detyrohet shtetit rezulton vlera 1.511.330 lekë, vlerë e cila duhet të pajiset nga Enti Kombëtar i Banesave. Deklaruesja në përgjegjësinë e saj deklaroi se ka marrë çekun nga EKB-ja, në vlerën 1.511.330 lekë; mandat nga Banka e Kursimeve datë 21.3.2003, ku znj. Dhurata Bilo ka marrë nga arka shumën 1.510.330 lekë; vërtetim nga Bashkia Berat datë 23.2.1996, ku vërtetohet se znj. Dhurata Bilo banon në konvikt dhe si rezultat i zbatimit të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, del e pastrehë.

⁸ Me shkresën nr. ** prot., datë 6.3.2020.

⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2020.

OSHEE-ja¹⁰ ka informuar se në emër të znj. Dhurata Bilo, referuar të dhënave të sistemit të faturimit identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. DU*A****, data e fillimit të furnizimit është 28.3.2007, në instancën e Durrësit.

Komisioni ka kërkuar informacion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për ndonjë rast të mundshëm konflikti interesi me palën shitëse znj. F.B.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës¹¹ ka informuar se kjo shtetase nuk ka pasur procese gjyqësore pranë kësaj gjykate, të shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit Dhurata Bilo.

Nga aktet e depozituara nga subjekti rezulton një kontratë shitblerjeje me nr. ***, datë 22.10.2002, për blerjen e banesës me sip. 400 kut, në Durrës, në çmimin 2.000.000 lekë, me palë shitëse F. B dhe palë blerëse Dhurata Bilo. Nga vërtetimi i dokumentit hipotekor të datës 30.12.2002, rezulton se pasuria është me sipërfaqe truall 154.14 m² dhe sip. ndërtimi 71.64 m². Në vërtetim pasuria përshkruhet “shtëpi banimi 400 kut”.

Në kontratë citohet se: *“Pagesa u bë cash për të gjithë vlerën dhe para noterit. Nga pala blerëse deklarohet se është dakord me blerjen e shtëpisë së banimit, në qytetin e Durrësit, në vlerën e mësipërme të çmimit të shitjes së saj dhe në praninë time të noterit, me numrin të ndërsjellë i dorëzohet palës shitëse të gjithë vlerën e plotë të çmimit dhe pala shitëse nuk pati asnjë pretendim”.*

Nga hetimi i kryer rezultoi se subjekti me shitësen e kësaj pasurie zj. F.B ka nënshkruar një kontratë huaje me nr. ****, datë 22.10.2002, sipas së cilës, znj. F.B i ka dhënë hua subjektit Dhurata Bilo shumën 1.400.000 lekë, pa interes për një afat deri më 1.11.2003.

Në dosje rezulton një deklaratë noteriale nr. ***, datë 12.10.2003, sipas së cilës huan e marrë nga znj. F.B me aktin noterial nr. ***, datë 22.10.2002, në shumën 1.400.000 lekë, i është kthyer huadhënësit nga subjekti i rivlerësimit.

Subjekti, pasi e ka blerë këtë pasuri, ka vijuar me regjistrimin e saj dhe më 15.4.2003 ka nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje dhe investimi ndërtimor me nr. ***, ku si palë porositëse dhe investitore paraqitet subjekti i rivlerësimit dhe sipërmarrës inxh. Sh. K. Pronarja e truallit, znj. Dhurata Bilo, është dakord që me shpenzimet e saj të kryhet mbi sipërfaqen e tokës (400 kut) një rikonstruksion i plotë me strukturë dhe cilësi punimesh sipas projektit të miratuar nga KRRT-ja Durrës. Kati i parë të ndërtohen dy dhoma me sip. 80 m², kati i dytë me sip. 80 m² dhe nën çati të bëhet papafingo me sip. 25 m². Afati i përfundimit do të jetë data 15.7.2003. Ky rikonstruksion do të kryhet nga sipërmarrësi në vlerën 3.884.700 lekë, e cila është parapaguar nga pala investitore. Bashkëlidhur kontratës rezulton dhe një preventiv i detajuar në zëra, hartuar nga sipërmarrësi inxh. Sh.K, me shumë totale 4.861.000 lekë.

Referuar kontratës së sipërmarrjes shuma e rikonstruksionit është parapaguar nga subjekti e plotë në shumën 3.884.700 lekë. Afati i përfundimit të plotë të ndërtimit, përfshi edhe kolaudimin teknik të ndërtimit është deri më 15.7.2003.

Në dosje rezulton gjithashtu një vërtetim datë 24.1.2017, lëshuar nga NBG-ja, ku vërtetohet se znj. Dhurata Bilo ka marrë pranë bankës kredi për shtëpi në datën 25.3.2003, në shumën 15.000 USD dhe

¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2020.

¹¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.2.2021.

detyrimi i mbetur është në shumën 1.900 USD. Në datën 10.11.2004 ka marrë kredi në shumën 10.000 USD dhe detyrimi i mbetur është në shumën 2.982 USD.

Subjekti ka lëshuar një deklaratë noteriale nr. ***, datë 3.4.2003, e cila deklaron se mbështetur në relacionin e Drejtorisë Qendrore, mbi VKM-në nr. 153, datë 22.3.2001, “Për procedurat e operimeve financiare”, në zbatim të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, tarifa për 2 dhoma, 1 kuzhinë dhe ambiente ndihmëse është 1.840.820 lekë. Sipas tarifave, detyrimi ndaj shtetit për znj. Dhurata Bilo është në vlerën 329.490 lekë, duke e zbritur këtë vlerë nga tarifa e miratuar prej 1.840.820 lekësh, vlera e përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave është 1.511.330 lekë.

Gjithashtu, subjekti ka depozituar edhe një mandat të datës 21.3.2003, nga Banka e Kursimeve, ku znj. Dhurata Bilo ka tërhequr nga arka shumën 1.510.330 lekë.

Subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Berat në periudhën 24.12.1993 – 31.03.1998. Referuar vërtetimit datë 23.2.1996, lëshuar nga Bashkia Berat, subjekti i rivlerësimit ka banuar në konviktin bujqësor të qytetit, ish-pronë e vëllezërve L dhe, për pasojë, ka përfituar statusin e të pastrehës.

Enti Kombëtar i Banesave¹² informon se në arkivin e EKB-së, lidhur me subjektin Dhurata Bilo, rezulton se sipas vërtetimit të datës 15.11.2001, Bashkia Durrës ka trajtuar këtë qytetare me statusin e të “pastrehut”, germa “ç”: “*Qytetarët që banojnë në banesa shtetërore ish pronë private, si dhe ata qytetarë që banojnë si qiramarrës në banesa private*”. Bashkëlidhur praktikës rezulton një vërtetim lëshuar nga Bashkia Durrës, i datës 15.11.2001, ku citohet se bazuar në VKM-në nr. 49, datë 29.1.1993, Bashkia Durrës i ka miratuar z. Dhurata Bilo, “Statusin e të pastrehës”.

Referuar dokumentacionit, Komisioni ka evidentuar faktin se subjekti, si e pastrehë, ka përfituar shumën e dhënë nga Enti Kombëtar i Banesave Durrës, duke pasur në bashkëpronësi ¼ e apartamentit të prindërve dhe një banesë 2-katëshe + papafingo.

2.2 Burimet e krijimit për banesën dykatëshe + papafingo

Vlera e deklaruar nga subjekti për këtë pasuri është në shumën 3.400.000 lekë. Në DPV-në e parë, të vitit 2003, subjekti ka deklaruar banesë private 2 kate, me sip. trualli 225 m², vlera 3.400.000 lekë dhe burimi i krijimit të saj është deklaruar: *e blerë me të ardhurat e saj dhe kredi (pa u specifikuar cila kredi)*.

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se burimi i krijimit të kësaj pasurie është pjesërisht i përfituar nga ligji nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”.

Ka rezultuar se subjekti me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, nga shuma 2.000.000 lekë që i ka dhënë shitësit të saj, 1.400.000 lekë ia ka marrë hua shitëses së banesës, të cilën ia ka kthyer një vit më vonë.

Pasi u pyet nga Komisioni, subjekti ka depozituar¹³ një kontratë huaje me nr. ***, datë 22.10.2002, sipas së cilës, znj. F. B i jep hua subjektit Dhurata Bilo shumën prej 1.400.000 lekësh, pa interes për një afat deri më 1.11.2003.

¹² Me shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2021.

¹³ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 26.12.2020.

Në dosje rezulton një deklaratë noteriale me nr. ****, datë 2.10.2003, ku parashikohet se znj. Dhurata Bilo nëpërmjet këtij akti i dorëzon plotësisht shumën 1.400.000 lekë palës që ia kishte marrë znj. F.B, duke shlyer plotësisht detyrimin ndaj saj.

Pasi u pyet nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar¹⁴ se: “*Burimi i të ardhurave për blerjen e shtëpisë prej 2.000.000 lekësh vjen nga: 600.000 lekë kursimet e saj ndër vite dhe hua e marrë në shumë prej 1.400.000 lekësh, nga shtetasja F. B sipas kontratës së huas nr. ***, datë 22.10.2002.*”

Subjekti ka shpjeguar gjithashtu se: “*... shtetases F. B i ka dhënë shumën prej 600.000 lekësh në dorë, kurse 1.400.000 lekë kontratë huaje i shërbenin si garanci për shlyerjen e pjesës së mbetur për blerjen e shtëpisë në vlerën 20.000.000 lekë pasi ishte në pritje të marrjes së kontributit si e pastrehë nga Enti Kombëtar i Banesave. Burimi i vlerës për shlyerjen e huas është shuma 1.511.330 lekë për blerje shtëpie nga Enti Kombëtar i Banesave sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 3.4.2003. Vlera totale e investimit për rikonstruksionin/restaurimin e banesës është në shumën 1.400.000 lekë”.*

Nga verifikimi i deklarimeve, lidhur me burimin e krijimit për blerjen e kësaj banese ka rezultuar se:

- në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*... blerë dhe pjesërisht përfitur nga ligji nr. 8030, datë 15.11.1995, ‘Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha’*”;
- në DPV-në e parë të vitit 2003 ka deklaruar: “*... me kursimet në vite dhe kredia*”;
- gjatë procesit të rivlerësimit subjekti ka deklaruar: “*... me kursimet në vite dhe huan e marrë nga znj. F. B*”.

➤ Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore duket se deklaratimet e subjektit nuk përputhen me burimin e krijimit.

2.3 Në lidhje me ndërtimin shtesë

Referuar përgjigjes së ASHK-së Durrës¹⁵ dhe vërtetimit nga dokumenti hipotekor, pasuria e blerë nga subjekti rezulton me sipërfaqe trualli 152.14 m² dhe 71.64 m² ndërtesë. Referuar akteve të administruara në dosjen e ILDKPKI-së rezulton një kontratë sipërmarrjeje me nr. ****, datë 15.4.2003, sipas së cilës subjekti ka kontraktuar një inxhinier për të bërë shtesa në godinën ekzistuese, 80 m² në katin e parë dhe të dytë dhe 25 m² papafingo. Gjithashtu, subjekti, në DPV-në e parë të vitit 2003 ka deklaruar se zotëron një banesë private dykatëshe, me sip. trualli 225 m².

Nga aktet e dosjes nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë shtesë për pasurinë në pronësi të subjektit në ASHK Durrës.

Subjekti, pasi u pyet nga Komisioni, ka shpjeguar¹⁶ se: “*... në këtë banesë ka bërë rikonstruksion të kateve ekzistuese siç i janë dorëzuar nga shitësi dhe nuk ka bërë ndërtim të ri. Subjekti ka bërë vetëm përshtatje të ambienteve të brendshme në funksion të nevojave të saj personale pasi jeton vetëm, kurse projekti i rikonstruksionit ka qenë i parashikuar për një familje me disa kurora.*”

Në lidhje me koston totale të investimit të pasuria banesë dykatëshe, subjekti ka shpjeguar¹⁷ se: “*Investimi në total për rikonstruksionin/restaurim në banesën dykatëshe është 1.400.000 dhe mobilimi është rreth 800.000 lekë*”.

¹⁴ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 29.4.2020.

¹⁵ Me nr. *** prot., datë 6.3.2020.

¹⁶ Përgjigjet e pyetësorit të datës 26.12.2020.

¹⁷ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 29.4.2020.

Nga verifikimi i akteve është e paqartë se përse subjekti ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes me nr. ***, datë 15.4.2003, për kryerjen e shtesave në pasurinë banesë 2-katëshe, si dhe fakti që e ka depozituar në ILDKPKI, kur kjo kontratë sipas pretendimeve të saj nuk është ekzekutuar.

Sipas kontratës së sipërmarrjes për investim dhe ndërtim, të nënshkruar më 15.4.2003, sipërmarrësi ishte paguar në shumën 3.884.700 lekë dhe e pyetur nga Komisioni subjekti ka shpjeguar¹⁸ se: *“Kontrata e sipërmarrjes ka qenë një marrëdhënie juridike sipërmarrjeje, e cila u fillua por u ndërpre dhe punimet i ka kryer me njerëzit e saj. Për atë sa shoqëria e ndërtimit kreu punë unë kam qenë korrekte ndaj saj. Burimi i të ardhurave është kredia e marrë po këtë vit të cilën e kam shlyer me pagën time”*. Subjekti ka shpjeguar se kjo pasuri përdoret prej saj që nga momenti i ndërtimit dhe në vijim.

2.4 Analiza financiare

Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit për blerjen, rikonstrukcionin dhe mobilimin e apartamentit në vite, saktësisht për periudhën 1993 – 2008. Në analizën financiare u morën në konsideratë të ardhurat nga punësimi duke filluar nga viti 1993 e në vijim, të ardhurat nga shitja e automjetit tip “G”, si dhe të ardhurat e përfituara nga EKB-ja në vitin 2003. Gjithashtu, në analizë u përfshinë edhe shpenzimet jetike, blerjet e automjeteve, shpenzime shkollimi, shpenzime për udhëtime, si dhe shpenzimet e kësteve për dy kreditë¹⁹ që subjekti ka marrë në vitet 2003 dhe 2004 në NBG.

Nisur nga praktika të mëparshme të ngjashme, në mungesë të informacionit në lidhje me shpenzimet e mobilimit, nga natyra ato nuk mund të shtrihen në një periudhë 12-vjeçare, sikurse ka deklaruar subjekti në përgjigjet e pyetësorit të datës 26.12.2020, pasi kjo është banesa që subjekti ka banuar qëkur e ka blerë.

Komisioni ka përlllogaritur një shpërndarje të shumës prej 800.000 lekësh të deklaruar nga subjekti në masën 60% në vitin e parë pas përfundimit të rikonstrukcionit dhe pjesa tjetër e shpërndarë në tre vitet pasardhëse.

U analizuan dhe u përfshinë në këtë analizë likuiditetet bankare dhe huaja e marrë shtetases F.B, si dhe deklaramet që subjekti ka bërë në lidhje me gjendjet *cash* të kursimeve.

Në këtë analizë u reflektua shuma e cituar si e likuiduar në kontratën e sipërmarrjes me shtetasin Sh. K për punimet në ambientet e pasurisë, banesë dykatëshe, për shkak se subjekti nuk ka kryer revokimin e aktit noterial, kontratë sipërmarrje.

Analiza financiare është pasqyruar në tabelën vijuese.

¹⁸ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 29.4.2020.

¹⁹ Kontrata nr. ***, datë 19.2.2003, në shumën 15.000 USD, interes 5.4%. Afati i shlyerjes 15 vjet, si dhe kontrata nr. ***, datë 8.11.2004, në shumën 10.000 USD, interesi 8%. Afati i shlyerjes: 15 vjet.

Pershkrimi	1993-2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
PASURI	2 600 000	3 638 070	521 433	41 325	124 360	101 561	857 559
Shtepi banimi 2 kate me siperfaqe trualli 225 m2, blere ne 2002	2 000 000	3 884 700					
Autoveture Golf 3		350 000					
Autoveture Golf 4							611 513
DIFERENCE LIKUIDITETI	600 000	-596 630	521 433	41 325	124 360	101 561	246 047
LIKUIDITETE (FUND VITI)	600 000	3 370	524 804	566 129	690 490	792 051	1 038 098
Gjendje cash	600 000						
Likuiditete ne banke		3 370	524 804	566 129	690 490	792 051	1 038 098
DETYRIME	1 400 000	230 350	945 800	-	-	-	-
Kredi NBG 15.000 USD marre ne 2003 - per rikonstruksinin		1 630 350					
Kredi NBG 10.000 USD marre ne 2004 - per shtepine			945 800				
Hua marre shtetases F. B	1 400 000	-1 400 000					
PASURI NETO	1 200 000	3 407 720	-424 367	41 325	124 360	101 561	857 559
TE ARDHURA	2 864 923	2 092 287	766 750	787 279	771 999	811 092	1 087 631
Te ardhura Subjekti	2 864 923	580 957	766 750	787 279	771 999	811 092	887 631
Te ardhura nga shitja e Golf 3							200 000
Te ardhura dekl. Noteriale nga EKB		1 511 330					
SHPENZIME	1 087 095	213 716	258 136	892 015	542 801	716 036	649 479
Shpenzime jetese	1 087 095	93 964	93 964	109 557	109 557	235 968	136 620
Shpenzime udhetimi					42 678	0	59 491
Shpenzime shkollimi							61 591
Shpenzim mobilimi				480 000	106 667	106 667	106 667
Shpenzime per keset e kredive ne NBG bank		119 752	164 172	302 458	283 900	261 319	285 110
Shpenzime telefonie (statement RZB)						112 082	
REZULTATI FINANCIAR	577 829	-1 529 150	932 981	-146 062	104 837	-6 505	-419 407

Nga analiza financiare e kryer për periudhën 2003 - 2008 subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme të shtrira ndër vite, në shumë totale - 2.101.124 lekë.

Nga hetimi i kryer për këtë pasuri u konstatua:

- Mospërputhje deklarimesh për burimet e krijimit në deklaratën *Vetting*.
- Nuk provohet që punimet e kryera për rikonstruksin dhe shtesa të mos jenë kryer nga pala kontraktore sipas kontratës noteriale të sipërmarrjes.
- Mungesë burimesh të ligjshme për periudhën 2003 – 2008, në shumën - 2.101.124 lekë.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit për këtë pasuri, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Kushtetutës.

2.5 Qëndrimi i subjektit

i. Subjekti, në lidhje me mospërputhjet për burimet e krijimit, ka shpjeguar ndër të tjera se:

Pasi i është miratuar kredia nga Enti Kombëtar i Banesave sipas vendimit nr. 211, datë 29.3.2002, të Këshillit Bashkiak Durrës, ka filluar të shikojë për banesë dhe ka gjetur znj. F.B. Subjekti ka rënë dakord me znj. F.B, pasi e ka informuar se i është miratuar kredia nga Enti Kombëtar i Banesave, duke i treguar dokumentin përkatës, është dakordësuar për kalimin e pronësisë së banesës dhe për të siguruar shitësen e banesës, kanë nënshkruar kontratën e huas datë 22.10.2002. Kështu, paratë e marra nga EKB-ja janë përdorur për shlyerjen e huas së znj. F.B. Destinacioni i kredisë së dhënë nga EKB-ja Durrës ishte pikërisht shlyerja e banesës për të cilën pretendohet se e ka pasur.

ii. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se nuk provohet nga subjekti që punimet e rikonstruksin nuk janë kryer nga sipërmarrësi sipas kontratës noteriale, subjekti ka shpjeguar se rikonstruksin nuk u krye nga z. Sh. K, pasi banonte vetëm dhe nuk i duhej shtesa për të cilën kishte rënë dakord të kryente shitësja/F. B, sipas lejes që kishte marrë me sipërmarrësin.

Subjekti ka depozituar edhe një vërtetim të lëshuar nga DRT-ja Durrës me shkresën nr. **** prot., datë 24.2.2021, sipas së cilës vërtetohet se z. Sh.K për vitin 2003, ka deklaruar të ardhura në shumën 2.500.000 lekë.

Në mbështetje të shpjegimeve sa më sipër, subjekti, për të provuar se punimet nuk janë kryer sipas kontratës së sipërmarrjes me z. Sh. K ka depozituar:

- preventivin e punimeve të rikonstruksionit të kryera nga inxh. L.Sh, në qershor të vitit 2003;
- situacionin e punimeve të shtetasve R, F, Sh dhe K.R, qershor 2003 – mars 2004.

Subjekti ka shpjeguar se rikonstruksionin e banesës nuk e ka kryer me z. Sh.K në vlerën 3.838.470 lekë, por e ka bërë me vëllezërit R në vlerën 1.393.000 lekë. Referuar faktit që kryerja e këtyre punimeve u vu në diskutim nga Komisioni, subjekti ka siguruar preventivin e bërë nga inxh. L.Sh, si dhe situacionin e punimeve të bëra nga brigada e punimeve e përbërë nga babai R dhe vëllezërit F, Sh dhe K.R. Subjekti ka cilësuar se me vëllezërit R janë kushërinj (pasi nëna e tyre D është vajza e hallës së saj). Për këtë arsye ka shpjeguar më parë që punimet e rikonstruksionit i ka bërë me të afërmit e saj.

iii. Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, subjekti ka sqaruar se dispononte nga kursimet e saj në vitin 2002, vetëm shumën 600.000 lekë. Duke qenë se shuma nuk ka qenë detyrim për deklarim, pas rishikimit të analizës financiare shuma prej 600.000 lekësh nuk duhet të ishte konsideruar *cash* në fund të vitit 2002, pasi shumë është përdorur për blerjen e banesës.

Subjekti ka pretenduar gjithashtu se Komisioni nuk i ka përlllogaritur saktë shpenzimet për mobilim, duke mos provuar me dokumentacion pretendimin, por duke i ofruar Komisionit vlera të ndryshme në varësi të rezultatit për çdo vit.

2.6 Analiza ligjore

i. Në lidhje me mospërputhjet e burimeve të krijimit, në shtëpinë 2 kate plus papafingo, Komisioni argumenton se subjekti ka një kuptim të gabuar të fjalës “kredi”, pasi shumat e përfituar nga EKB-ja janë shuma të përfituara falas dhe jo kredi, siç ka deklaruar subjekti në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, sikurse deklaroi dhe në seancë.

ii. Në prapësime subjekti kundërshtoi të kishte kryer rikonstruksionin e kësaj banese me z. Sh. K, pavarësisht kontratës noteriale për shtesa dhe investime në banesë, të lidhur ndërmjet saj dhe këtij shtetasi. Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve, ka depozituar dokumentacion mbështetës:

- deklaratë noteriale nr. ***, datë 24.2.2021, të z. E.K;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 24.2.2021, të znj. F.B;
- preventivin e inxh. L.Sh, në qershor të vitit 2003;
- situacionin e punimeve të shtetasve R, F, Sh dhe K.R në qershor të vitit 2003;
- shkresën *** prot., datë 24.2.2021, nga DRT-ja Durrës;
- certifikatë familjare dhe certifikatë vdekje të z. Sh.K;
- nota transkriptimi për pasurinë truall me sip. 400 kut;
- vërtetim nga Bashkia Berat për statusin e të pastrehës;
- vërtetim nga Bashkia Durrës;
- vendim nga Gjykata Administrative dhe Gjykata e Apelit për procesin gjyqësor me Myftininë Durrës;

Komisioni analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe bazuar në dokumentacionin mbështetës të depozituar në prapësime, si dhe atë të administruar gjatë procesit dhe në përfundim, argumenton se duhen marrë në konsideratë faktet:

- subjekti sipas gjendjes civile paraqitet e vetme;
- nga fotot e depozituara të banesës evidentohet të jenë kryer rikonstruksione dhe punime cilësore në banesën dykatëshe, por jo shtesa në hapësira banimi;
- leja e miratuar për shtesa dhe investim në banesë është marrë nga znj. F.B, sipas nevojës së saj për shtesa dhe investim në banesën dykatëshe;
- nga të dhënat e tatimeve për sipërmarrësin z. Sh. K, të ardhurat e deklaruara për vitin 2003 janë në shumën 2.500.000 lekë. Këto të dhëna tregojnë se ky shtetas nuk mund të ketë kryer investimin në vlerën 3.800.000 lekë;
- preventiv i punimeve të rikonstruksionit nga inxh. L. Sh, në qershor 2003;
- situacioni i punimeve të shtetasve R, F, Sh dhe K.R, qershor 2003 – mars 2004;
- nga të dhënat bankare provohet se subjekti ka marrë kredi për rikonstruksion në vitin 2003, në shumën 15.000 USD.

Trupi gjykues arriti në konkluzionin se shpjegimet e subjektit duhet të pranohen sepse janë bindëse dhe të mbështetura në prova, ku indirekt provohet se punimet mund të mos jenë kryer nga sipërmarrësi z. Sh. K, pasi në banesë nuk evidentohen ndërtime “shtesë” sipas lejes së ndërtimit të marrë më parë nga znj. F.B.

Për këtë arsye, në analizën financiare të rikryer, u hoqën shpenzimet që subjektit i ishin llogaritur nga Komisioni për kryerjen e shtesës me ndërtuesin z. Sh. K.

iii. Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme

Pretendimi në lidhje me kursimet në vitin 2002, në shumën 600.000 lekë, u mor në konsideratë për faktin se subjekti nuk kishte detyrim për deklarim në vitin 2002 dhe nga analiza financiare duket se subjekti kishte mundësi për t'i pasur këto kursime.

Sa më sipër, Komisioni reflektoi në analizë këto ndryshime dhe për periudhën 2003 – 2008, përfundimisht ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme në shumën - 571.974 lekë.

Për sa më sipër, nuk u provuan bindshëm të ardhurat për krijimin e kësaj pasurie në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli lidhur me pasurinë e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

3. Automjet²⁰ tip “M-B ** CDI”, viti i prodhimit 2003, blerë më 29.1.2010

Vlera e deklaruar: 6.000 euro.

²⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: leje qarkullimi rrugor për automjetin tip “M-B”, me targa DR ****F, në emër të znj. Dhurata Bilo + kontratë shtiblerje datë 25.1.2010, në vlerën 6.000 euro + deklaratë doganore, paguar 356.842 lekë; leje qarkullimi rrugor për automjetin me targa DR ***C + kontratë shitje nr. ****, datë 1.8.2008, shitës Dhurata Bilo dhe blerës S dhe A.D, në vlerën 200.000 lekë + kontratë gjermane ku znj. Dhurata Bilo ka blerë automjetin në vlerën 1.200 euro + deklaratë doganore paguar 158.537 lekë; leje qarkullimi rrugor për automjetin me targa DR **** C + kontratë shitje nr. ****, datë 22.2.2010, shitës Dhurata Bilo dhe blerës I.M, në vlerën 9.000 euro + kontratë gjermane ku znj. Dhurata Bilo ka blerë automjetin në vlerën 1.300 euro + deklaratë doganore paguar 241.965 lekë.

Pjesa në përqindje: zotëron 100%.

Burimi i krijimit: nga shitja e automjetit tip “V. G”.

Deklarimi në DPV²¹: subjekti e ka blerë automjetin në datën 25.1.2010, por e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2009. Ka deklaruar shitjen e automjetit tip “G *”, blerë “B, pa dhënë burim krijimi.

Mënyra e fitimit: me kontratën datë 25.1.2010.

3.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

DPSHTRr-ja²² konfirmon se znj. Dhurata Bilo ka pasur të regjistruar në pronësinë e saj automjetin tip “M-B”, blerë me kontratën e shitblerjes datë 25.1.2010, në vlerën 6.000 euro. Referuar deklaratës doganore rezulton se subjekti ka paguar detyrimet për zhdoganimin e këtij automjeti në shumën 356.842 lekë. Nga verifikimi i mandatpagesës bankare rezulton se detyrimet doganore janë paguar më 29.1.2010.

3.2 Komisioni analizoi burimin e krijimit

Referuar deklarimeve rezulton se si burim për blerjen e automjetit subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit tip “G. *”, në pronësi të saj dhe, më pas, ka blerë automjetin tip “M-B”. Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit²³, ka depozituar kontratën e shitblerjes nr. ****, datë 22.2.2010, me të cilën ka shitur automjetin tip “V.G”, me çmim shitjeje 9.000 euro.

3.3 Hetimi i kryer nga Komisioni

Në lidhje me automjetin tip “G. *”, të shitur nga subjekti me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 22.2.2010, në çmimin 9.000 euro, ka rezultuar se subjekti në DPV-në e vitit 2008 ka deklaruar se ka blerë automjetin tip “G *” në shumën 3.000 euro. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se: *“Në datën 1.8.2008 me anë të kontratës së shitjes - automjeti, me nr. *** rep., *** kol., datë 1.8.2008, përfitova 200.000 lekë, të cilat i përdora për zhdoganimin e makinës tip ‘V. G *’, të cilën e bleva në vlerën 3.000 euro, plus 241.965 lekë detyrim doganor e ardhur në portin e Durrësit datë 30.7.2008”.*

Referuar akteve në dosje ka rezultuar se automjeti i blerë në vitin 2008, në shumën 3.000 euro + 241.965 detyrim doganor, i është shitur në datën 22.2.2010 shtetasit I. M, në shumën 9.000 euro.

Komisioni hetoi në lidhje me konfliktin e interesit, për shkak se çmimi i shitjes së automjetit tip “G *” duket jo në vlera reale, duke kërkuar informacion për procese gjyqësore të mundshme të blerësit të automjetit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, me gjyqtare Dhurata Bilo.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës²⁴ ka depozituar informacion mbi proceset gjyqësore që ky shtetas ka pasur pranë kësaj gjykate, nga ku rezultoi se:

- i. Shtetasi I.M, i biri i I, viti I lindjes 1953, banues në lagjen ** Sh. Durrës, ka pasur një proces gjyqësor me një trupë gjyqësore, të kryesuar nga gjyqtare Dhurata Bilo.

²¹ DPV e vitit 2009.

²² Me shkresën nr. *** prot., datë 28.1.2020.

²³ Datë 26.12.2020.

²⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.2.2021.

Vendimi nr. ***, datë 29.10.2002, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës rezulton se ka pasur palë: paditës I. M, të paditur Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, person i tretë A.B dhe me objekt plotësimi i vendimit nr. ***/1994, të KKKPronave, duke iu kthyer e lirë sip. 5.000 m² tokë.

Në përfundim të gjykimit, gjykata ka vendosur: *“Pranimin e padisë së paditësit I.M duke u plotësuar vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës ish-pronarëve, duke i kthyer në natyrë sipërfaqen e lirë prej 3552 m², ndodhur brenda sipërfaqes së njohur prej 25 dynym ...”*.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Lartë nuk ka pranuar rekursin e paraqitur ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit.

ii. Shtetasi I. M, i biri i I, viti I lindjes 1953, banues në lagjen ** Sh. Durrës, ka pasur një proces tjetër gjyqësor me gjyqtar subjektin e rivlerësimit Dhurata Bilo.

Vendimi nr. ***, datë 28.5.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës rezulton se ka palë paditës I. M, të paditur A. B dhe me objekt “detyrimin e të paditurit të lirojë dhe dorëzojë tokën e zënë me sip. 1102 m²”.

Në përfundim të gjykimit gjykata ka vendosur: *“Pranimin e padisë të paditësit I. M, detyrimin e të paditurit A.B t’i lirojë dhe dorëzojë sipërfaqen e tokës truall + ndërtesë ndodhur në lagjen **...”*.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Lartë nuk ka pranuar rekursin e paraqitur ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës.

iii. Shtetasi I.M, i biri i I dhe i V dtl 3.10.19**, ka pasur një proces tjetër gjyqësor me gjyqtar subjektin e rivlerësimit Dhurata Bilo.

Vendimi nr. **-2020-***, datë 28.7.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës rezulton se ka palë paditës Xh.P, të paditur I.M dhe përmbarese gjyqësore F.I dhe me objekt gjykimi “pezullimi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv të vendimi civil nr. ***, datë 24.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, lënë pjesërisht në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës.

Në përfundim të gjykimit, gjykata ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit Xh. P...”*.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit me palën kontraktuese, së cilës i ka shitur automjetin tip “G. **”, në datën 22.2.2010, në shumën 9.000 euro, ka zhvilluar 3 procese gjyqësore, 2 përpara shitjes së automjetit në vitet 2002 dhe 2007 dhe të fundit në vitin 2020.

3.4 Analiza financiare

Nga verifikimi i akteve rezulton se subjekti e ka blerë automjetin tip “M-B”, në datën 25.1.2010, në vlerën 6.000 euro dhe ka paguar detyrimet doganore në datën 29.1.2010, ndërkohë që automjetin tip “G” e ka shitur në datën 22.2.2010.

Referuar datave të kontratave ka rezultuar se subjekti nuk mund ta ketë blerë automjetin tip “M-B” me të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “G”, pasi ky i fundit është shitur pas 3 javësh.

Komisioni analizoi mundësitë financiare të subjektit në datën 29.1.2010 për blerjen e automjetit dhe nga verifikimi i deklaramit periodik për vitin 2009, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* dhe, për rrjedhojë, ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

3.5 Nga hetimi, për këtë pasuri, u konstatua se:

- Subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit tip “M-B”, në datën 29.1.2010, në shumën -1.184.602 lekë (6.000 euro çmimi i blerjes + 356.842 lekë dogana).
- Subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2010 shumën e përfituar nga shitja e automjetit tip “G*”.
- Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të automjetit tip “M-B” në vitin 2010 dhe as në deklaratën *Vetting*.
- Subjekti ka hyrë në marrëdhënie juridike private me një shtetas, të cilit i ka zhvilluar 3 procese gjyqësore.

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Kushtetutës.

3.6 Qëndrimi i subjektit

Subjekti, në prapësime, ka shpjeguar se: *“... me shtetasin I.M nuk ka asnjë lidhje as miqësore as familjare as njohje me të. Subjekti pretendon se sikurse ka shpjeguar dhe Komisioni, 2 nga proceset gjyqësore të zhvilluara me këtë palë janë përpara se të shitej makina dhe janë vendime gjyqësore të cilat janë lënë në fuqi nga gjykatat më të larta.*

Gjithashtu, unë nuk mund të parashikoj se kujt do t’ia shisja makinën, që e kam blerë në vitin 2008 e të mos bëja procese gjyqësore me të, në vitet 2002 dhe 2007. Pra, unë akoma nuk e kisha blerë makinën në çastin kur kam bërë procese gjyqësore me këtë shtetas për këto 2 vendime”.

Sa i përket procesit të fundit, subjekti ka shpjeguar se ky proces ka pasur objekt gjykimi “Pezullimi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv që është vendimi civil nr. ***, datë 24.7.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ndryshuar me vendimin civil nr. ***, datë 18.4.2019 dhe pjesërisht lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës. Deklarimi i pavlefshëm i titullit ekzekutiv, vendimit civil nr. ***, datë 24.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe vendimit civil nr. ***, datë 18.4.2019, të Gjykatës së Apelit Durrës, se detyrimi nuk ekziston, etj.”.

Subjekti ka shtuar se: *“... në këto rrethana, të drejtën e titullit ekzekutiv këtij shtetasi nuk ia kam dhënë unë, por vendimi nr. ***, datë 24.7.2018 i lënë në fuqi me vendimin nr. **, datë 18.4.2019, të Gjykatës së Apelit. Për më tepër, ky vendim është dhënë në një periudhë 10-vjeçare, pasi unë kam shitur makinën tip ‘G’. Në këto rrethana, unë nuk kam se si të isha në konflikt interesi, se pse i kam shitur një makinë para 10 vjetësh. Për më tepër, ky vendim është lënë në fuqi edhe nga gjykata e apelit dhe për të nuk është bërë rekurs. Realisht, unë nuk e mbaja mend fare këtë zotëri dhe është krejt normale që pas 10 vjetësh mos ta kujtosh një njeri të cilin e ke takuar vetëm një herë përpara noterit. Ky proces gjyqësor ka ardhur tek unë nga gjyqtare M.M, në momentin që ajo është futur në skemën e delegimit në Gjykatën e Apelit Korçë. Rastet e konfliktit të interesit e shkakut të dorëheqjes janë parashikuar në pika ‘e’, e nenit 72, të Kodit të Procedurës Civile.*

Në asnjë pikë të kësaj dispozite nuk parashikohet situata konkrete. Edhe në pikën 6 ku thotë në çdo rast tjetër, kjo lidhet me një rrethanë konkrete për arsye serioze njëanshmërie. Situata konkrete do të thotë situata ekzistente, madje ligjvënësi edhe në këtë rast thotë se edhe nëse ka një situatë konkrete, duhet të ketë arsye serioze njëanshmërie.

Në këtë analogji, me arsyetimin tuaj, nëse do të konsiderohej çdo marrëdhënie juridike arsye serioze atëherë nuk mund të bëj gjyq me bashkinë apo çdo organ shtetëror pasi kam marrë kredi nga enti i

banesave etj. Në këto rrethana, ky konstatim i Komisionit nuk lidhet me asnjë arsye serioze njëanshmërie sipas përcaktimit të ligjit”.

Në lidhje me datën e marrjes së shumave, subjekti ka argumentuar se kur ka shitur automjetin tip “G” në fillim të janarit të vitit 2010, blerësi i ka lënë kapar vlerën 7.000 euro dhe brenda muajit shkurt ka bërë likuidimin e vlerës së mbetur. Për këtë arsye edhe kontrata e shitjes është bërë më 22.2.2010. Për këtë, blerësi I. M ka lëshuar deklaratë noteriale ku deklaroi se pagesën e kaparit prej 7.000 euro ia ka paguar subjektit më 19.1.2010 dhe pjesën e mbetur prej 2.000 euro e ka shlyer më 22.2.2010, në momentin e nënshkrimit të kontratës.

3.7 Analiza ligjore

Trupi gjykues, në lidhje me deklaratën e nënshkruar nga blerësi i automjetit tip “G”, shtetasi I. M., përpara noterit publik, arsyeton se ky është një akt i hartuar shumë kohë pasi ka ndodhur shitja e automjetit (10 vjet më pas), është në nivel deklarativ i pa shoqëruar me asnjë provë dhe, për pasojë, nuk justifikon dhe nuk ka nivelin e provueshmërisë për pagesën e shumës 7.000 euro si parapagim/kapar për blerjen e automjetit.

Referuar kontratës së shitjes së automjetit, lidhur mes subjektit dhe blerësit I. M në datën 22.2.2010, nuk rezulton që deklarimi i blerësit, pra, pagesa e kaparit prej 7.000 euro të jetë pasqyruar në kontratën e shitblerjes. Në lidhje me analizën financiare, Komisioni arsyeton se edhe nëse do të merren për bazë shpjegimet e subjektit nuk do të llogaritet në analizën financiare shuma prej 7.000 euro, pasi për këtë shumë subjekti nuk ka paguar tatimin në burim që ka rezultuar nga çmimi i shitjes së automjetit me çmimin e blerjes.

Trupi gjykues, në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme, arsyeton se shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk mund të pranohen, pasi nuk provohet të ketë marrë paradhënie shumë 7.000 euro pavarësisht deklaratës noteriale të depozituar pas kalimit të barrës së provës. Nga analiza e kryer ka rezultuar pamjaftueshmëri likuiditetesh për blerjen e automjetit.

Për sa më sipër, nuk u provuan bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e automjetit në përputhje me pikën 3, të neni D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

4. Apartament²⁵ me sip. 102 m², në Golem-Durrës, blerë në vitin 2013

Vlera e deklaruar: 41.600 euro.

Pjesa në përqindje: zotëron 100%.

Burimi i krijimit: shlyer shuma 31.600 euro, nga të cilat 10.000 euro nga llogaria nr. ****, pjesa tjetër nga kursimet në vite, *cash* në banesë.

²⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë sipërmarrje nr. ****, datë 4.4.2013, investitor shoqëria “K” sh.p.k. dhe porositetë Dhurata Bilo, për apartament me sip. 102 m², që ndodhet në vilën nr. *, k. *-të. Likuidimi do të bëhet me këste, kësti i parë në vlerën 20.000 euro, kësti i dytë 11.600 euro deri më 30.5.2013 dhe kësti i tretë 10.000 euro, do të shlyhet me kalimin e pronësisë në emër të pronarit + praktika bashkëlidhur; mandatpagesë datë 22.6.2013, nga BKT-ja ku rezulton se znj. Dhurata Bilo ka derdhur për këstin e dytë sipas kontratës së sipërmarrjes nr. **, shumën 11.600 euro; vërtetim datë 29.3.2014, nga “Raiffeisen Bank” ku vërtetohet se znj. Dhurata Bilo ka bërë tërheqje në shumën 10.000 euro + mandat tërheqje datë 28.3.2014, nga “Raiffeisen Bank”, shuma 10.000 euro.

Deklarimi në DPV²⁶: shlyer shuma 31.600 euro, nga të cilat 10.000 nga llogaria bankare dhe pjesa tjetër kursime *cash* në banesë.

Mënyra e fitimit: me kontratën e sipërmarrjes nr. *****, datë 4.4.2013.

4.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ASHK-ja Durrës²⁷ informon se apartamenti me sip. 102 m² nuk rezulton të jetë regjistruar në emër të subjektit.

OSHEE-ja²⁸ informon se në emër të znj. Dhurata Bilo, referuar të dhënave të sistemit të faturimit identifikohet një abonent me kontratë furnizimi me nr. AL*****, në instancën e Kavajës.

4.2 Burimi i krijimit

Në lidhje me burimin e të ardhurave për këtë pasuri, subjekti, edhe në DPV-në e vitit 2013 edhe në deklaratën *Vetting*, ka mbajtur të njëjtin qëndrim duke argumentuar se është shlyer shuma 31.600 euro, nga të cilat 10.000 nga llogaria bankare e deklaruar dhe pjesa tjetër kursime *cash* në banesë.

Në përgjigjet e pyetësorit²⁹ subjekti ka shpjeguar se: “*Vlera totale prej 41.600 euro do të paguhej në 3 këste. Duke qenë se ndërtimi nuk ka përfunduar, kësti i tretë prej 10.000 euro nuk është paguar.*”

*Subjekti për burimin ka shpjeguar se 20.000 euro janë kursime të viteve, 11.600 euro - në vitin 2009, me deklaratën noteriale nr *** rep., **** kol., datë 12.12.2009, lëshuar nga nëna e saj Q.B, ka përfutuar shumën 1.100.000 lekë (një milion e njëqind mijë lekë). Kjo shumë është pensioni i nënës i pa tërhequr dhe i akumuluar që prej vitit 1997 deri në vitin 2009”.*

Referuar shpjegimeve të subjektit rezulton se ndër vite subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*. I vetmi vit kur është bërë deklarim për gjendje *cash* është viti 2013, ku ka deklaruar gjendje 600.000 lekë.

4.3 Analiza e fakteve

Nga aktet e dosjes rezulton se subjekti ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje me nr. *****, datë 2.4.2013, me investitor shoqërinë “K” sh.p.k. dhe porositëse Dhurata Bilo, për apartamentin me sip. 102 m², që ndodhet në vilën nr. *, kati i *-të.

Referuar kontratës është parashikuar se likuidimi për blerjen e pasurisë do të bëhet me 3 këste:

- kësti i parë në shumën 20.000 euro, likuiduar në datën (2.4.2013) e nënshkrimit të kontratës;
- kësti i dytë në shumën 11.600 euro deri më 30.5.2013; dhe
- kësti i tretë në shumën 10.000 euro do të shlyhet me kalimin e pronësisë në emër të pronarit + praktika bashkëlidhur.

Referuar akteve, kjo pasuri është ende e pa regjistruar, pra, subjektit nuk i ka kaluar pronësia e kësaj pasurie.

Subjektit i është kërkuar nga Komisioni që të shpjegojë dhe të dokumentojë pagesat e kryera për këtë pasuri. Subjekti ka shpjeguar³⁰ se: “... mënyra e shlyerjes së kësaj vlere 41.600 euro do të paguhej me 3 këste. Deri tani janë paguar:

²⁶ DPV e vitit 2013.

²⁷ Me shkresën nr. ***** prot., datë 6.3.2020.

²⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2020.

²⁹ Datë 29.4.2021.

³⁰ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 29.4.2020.

- 20.000 euro, më 2.4.2013, me nënshkrimin e kontratës (20.000 euro kursime ndër vite);
- 11.600 euro më 28.6.2013 (në vitin 2009, me deklaratën noteriale nr. ****, datë 12.12.2009, lëshuar nga nëna e saj Q.B, ka përfituar shumën 1.100.000 lekë (një milion e njëqind mijë lekë). Kjo shumë është akumuluar nga pensioni i pa tërhequr dhe i akumuluar që prej vitit 1997 deri në vitin 2009.

Kësti i tretë prej 10.000 euro do të shlyhet në momentin e kalimit të pronësisë (kjo pronë nuk është regjistruar pasi nuk ka përfunduar ende ndërtimi, ndaj ky këst është i pashlyer), meqenëse nuk ka përfunduar ende ndërtimi, në të nuk banon askush”.

- Nga aktet konstatohet se subjekti, që nga viti 2013 kur ka porositur apartamentin e në vijim, nuk ka deklaruar asnjëherë shumën e mbetur si detyrim shoqërisë së ndërtimit, sipas kontratës së sipërmarrjes.

4.4 Analiza financiare

Komisioni analizoi mundësinë e pagesës së këstit të parë. Subjekti, në DPV-në e vitit 2013 ka deklaruar: *“Janë shlyer 31.600 euro, nga të cilat 10.000 nga llogaria bankare dhe pjesa tjetër nga kursimet cash në banesë”*. Në pyetësorin e dërguar nga Komisioni për të shpjeguar në mënyrë shteruese burimin e pasurisë, subjekti ka deklaruar se kësti i parë në shumën 20.000 euro është paguar me kursimet në vite. Nga verifikimi i deklarimeve në DPV-të periodike ndër vite, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar kursime *cash* në banesë shumën 600.000 lekë, në vitin 2012.

4.5 Nga analiza financiare e kryer rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi për të paguar këstin e parë në datën 2.4.2013, pasi ka një balancë negative në shumën - **2.204.200 lekë**.

4.6 Në lidhje me mundësinë e pagesës së këstit të dytë, në datën 28.6.2013, në shumën 11.600 euro, subjekti ka deklaruar se i ka paguar nga të ardhurat e përfituara nga akumulimi i pensionit të nënës së saj, sipas deklaratës noteriale datë 12.12.2009. Nga verifikimi i deklarimeve në DPV dhe i nxjerrjes së llogarive bankare ka rezultuar se subjekti i ka konvertuar fondet e dhuruara nga nëna në monedhën euro dhe i ka depozituar në “Raiffeisen Bank” në datën 2.8.2010, në shumën 10.000 euro.

Referuar DPV-së së vitit 2010, subjekti ka deklaruar se: *“Shuma e përfituar nga nëna një vit më parë është depozituar në RBAL në depozitë me afat në shumën 10.000 euro, në datën 24.3.2011”*. Nga verifikimi i kësaj llogarie në “Raiffeisen Bank” ka rezultuar se subjekti i ka tërhequr të gjitha fondet nga banka dhe kjo depozitë është mbyllur plotësisht në datën 28.3.2014.

Për sa u shpjegua nga lëvizjet bankare, duket se pagesa e këstit të dytë për blerjen e apartamentit nuk mund të jetë kryer me likuiditetet e ndodhura në këtë llogari sikurse ka pretenduar subjekti, pra shuma e përfituar nga nëna nuk mund të ketë shërbyer si burim për pagesën e këtij kësti, pasi subjekti i ka pasur këto shuma të depozituara në bankë dhe pas datës kur është paguar kësti i dytë prej 11.600 euro.

4.7 Nga analiza e kryer për pagesën e këstit të dytë rezultoi se ka një balancë negative në shumën - **1.626.436 lekë**, sikurse pasqyrohet në tabelën vijuese:

Nga analiza financiare e kryer për vitin 2013, subjekti rezulton me një mungesë të burimeve të ligjshme për pagesat e kryera për blerjen e apartamentit në Golem, në shumën - 3.830.636 lekë.

	Data e pageses se keshtit	Shuma ne euro	Shuma ne leke	Burimi i deklaruar	Rezultati financiar
Kesti 1	2.4.2013	20 000	2 804 200	Kursime ne vite	- 2 204 200
Kesti 2	28.6.2013	11 600	1 626 436	Te ardhurat nga pensioni i nenes (1.1 mln leke)	- 1 626 436
Kesti 3	nuk eshte paguar ende	10 000			
Totali		41 600			- 3 830 636

4.8 Nga hetimi për apartamentin në Golem - Durrës, u konstatua se:

- Subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për dy pagesat e kryera në shumën 31.600 euro, në vitin 2013, për blerjen e apartamentit.
- Pasaktësi në plotësimin e deklaratave të pasurisë periodike nga viti 2013 e në vijim, pasi te rubrika e detyrimeve financiare, subjekti nuk ka deklaruar detyrimin financiar në shumën 10.000 euro, ndaj shoqërisë “K” sh.p.k., për apartamentin me sip. 102 m².

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Kushtetutës.

4.9 Qëndrimi i subjektit

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjekti, në prapësimet e depozituara ka pretenduar se nuk ka deklaruar kursime *cash* në deklaratimet periodike vjetore përveçse në vitet 2012, 2014, 2015 dhe 2016. Pasuria apartament është blerë në vitin 2013.

Në lidhje me pretendimin se paratë që ia ka dërguar vëllai, i ka përdorur për të paguar këstet e apartamentit, subjekti bie në kundërshtim me përgjigjet në pyetësonin nr. 2, ku shpjegon se: “... në lidhje me burimin e kësteve të apartamentit: shuma 20.000 euro ka qenë kursim i viteve dhe 11.600 euro me deklaratën noteriale nr. ****, datë 12.12.2009, lëshuar nga nëna ime Q. B, kam përfituar shumën 1.100.000 lekë (një milion e njëqind mijë lekë)”.

Gjithashtu në pyetësonin nr. 3, e pyetur për shumën 9.985 euro, mbërritur me transfertë nga Italia, në emër të shtetasve A. B dhe E.K, e kredituar më 19.7.2011, në llogarinë e subjektit, ajo ka shpjeguar se: “Kjo shumë e sipërcituar, kredituar në llogarinë time është dërguar nga vëllai im A.B dhe bashkëshortja e tij E.K për vazhdimin e shtesës anësore dhe restaurimin e apartamentit të prindërve, ku dhe ai është bashkëpronar, e ndodhur në lagjen **, Rr. ‘K.K’, p. **, k. **, për ta pasur si bazë gjatë qëndrimit në Shqipëri, pasi kishte rënë dakord me një ndërtues që do ta përfundonte me këtë shumë.

Kjo marrëveshje paraprake verbalisht nuk u realizua dhe në muajt në vazhdim vëllai, kur erdhi në Shqipëri, e rimori përsëri shumën e sipërcituar me vete në Itali.”

Pra, subjekti, në prapësime ka sjellë një shpjegim që bie ndesh me shpjegimet e dhëna gjatë procesit të hetimit dhe deklaratimeve të saj në DPV.

4.10 Analiza ligjore

Trupi gjykues argumenton se referuar pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet se “Deklarimet e interesave private dhe pasurore të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit”, subjekti, në vite nuk ka deklaruar gjendje *cash*. Për pasojë, kursimet *cash* të padeklaruara në DPV në vite, në zbatim edhe të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, nuk mund të konsiderohen si të ardhura të akumuluar të subjektit.

Komisioni, në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme të rezultuar nga analiza financiare, argumenton se shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk mund të pranohen, pasi referuar deklaramëve periodike në vite, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*.

Gjithashtu, Komisioni nuk pranoi shpjegimet e subjektit për pagesën e këstit të dytë me të ardhurat e akumuluar nga pensioni i nënës, pasi u provua gjatë hetimit administrativ që këto shuma kanë qenë të depozituara në “Raiffeisen Bank” edhe pasi është paguar shuma e këstit të dytë. Për rrjedhojë, subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e apartamentit në Golem - Durrës.

Për sa më sipër, nuk u provuan bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në Golem - Durrës, në përputhje me pikën 3, të neni D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

5. Llogari rrjedhëse në shumën 14.868 euro, në “Raiffeisen Bank”³¹, hapur më 8.2.2010

Pjesa në përqindje: zotëron 100%.

Burimi i krijimit: kursime nga paga e tre viteve të fundit.

Deklarimi në DPV³²: në DPV-në e vitit 2013, gjendja e llogarisë ka qenë 390.16 euro.

“Raiffeisen Bank”³³ ka konfirmuar se znj. Dhurata Bilo disponon llogari rrjedhëse me gjendje në datën 30.1.2017, në vlerën 14.868. euro.

5.1 Komisioni analizoi deklaramët periodike të subjektit ndër vite, nga ku ka rezultuar se:

- në vitin 2014 është deklaruar shuma 600.000 lekë *cash* në banesë;
- në vitin 2015 është deklaruar shuma 1.300.000 lekë *cash* në banesë;
- në vitin 2016 subjekti deklaroi se shumatat e deklaruara janë kthyer në euro dhe janë depozituar në bankë.

Komisioni, nga analizimi i deklaramëve periodike vjetore, ka rezultuar se kursimet e deklaruara *cash*, kanë shërbyer si burim për shumën 14.868 euro.

6. Detyrimet financiare³⁴

Subjekti ka deklaruar se vazhdon shlyerja e kredisë, marrë nga NBG-ja sh. a., agjencia Durrës, si vijon: NBG-ja, me shkresën nr. ***, datë 24.7.2017, konfirmon se znj. Dhurata Bilo ka marrë dy kredi pranë kësaj banke, si dhe ka detyrime për secilën në shumatat 1.900.06 USD dhe 2.982.39 USD.

Nga verifikimi i deklaramëve, deklaramët e subjektit përputhen me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e NBG-së.

³¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaramët: vërtetim nr. ***, datë 28.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, ku konfirmohet se znj. Dhurata Bilo ka hapur llogari më 8.2.2010 dhe gjendja e saj në datën 28.1.2017 është 14.868.24 euro.

³² DPV e vitit 2013.

³³ Me shkresën nr. ***, datë 24.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

³⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaramët: kontratë kredie datë 19.2.2003 me kredimarrëse Dhurata Bilo dhe kredidhënës NBG, në shumën 15.000 USD, me qëllim ndërtim banese, me barrë hipotekore; kontratë kredie datë 8.11.2004 me kredimarrëse Dhurata Bilo dhe kredidhënës NBG, në shumën 10.000 USD, me qëllim ndërtim banese, me barrë hipotekore.

Analiza financiare përmbledhëse pas prapësimeve për periudhën 1993 – 2016

PERIUDHA	PASURI	DIFERENCË LIKUIDITETI	DETYRIME	PASURI NETO	TË ARDHURA	SHPENZIME	REZULTATI FINANCIAR
1993-2002	2 000 000	-	1 400 000	600 000	2 864 923	1 087 095	1 177 829
2003	1 753 370	3 370	230 350	1 523 020	2 092 287	213 716	355 550
2004	521 433	521 433	945 800	- 424 367	766 750	258 136	932 981
2005	41 325	41 325	-	41 325	787 279	892 015	- 146 062
2006	124 360	124 360	-	124 360	771 999	542 801	104 837
2007	101 561	101 561	-	101 561	811 092	716 036	- 6 505
2008	857 559	246 047	-	857 559	1 087 631	649 479	- 419 407
2009	357 606	357 606	-	357 606	2 154 826	835 497	961 723
2010	1 215 899	31 297	-	1 215 899	1 612 249	1 291 268	- 894 919
2011	10 443	10 443	-	10 443	1 021 735	898 433	112 859
2012	604 408	604 408	-	604 408	1 040 132	738 667	- 302 943
2013	3 881 725	- 548 911	1 402 100	2 479 625	1 064 101	646 738	- 2 062 261
2014	- 753 647	- 753 647	-	- 753 647	1 281 759	759 000	1 276 406
2015	727 857	727 857	-	727 857	1 282 484	755 044	- 200 416
2016	654 990	654 990	-	654 990	1 374 461	757 955	- 38 483

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni për vlerësimin e kriterit të pasurisë, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancat dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se znj. Dhurata Bilo:

- i. Nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimet e ligjshme të pasurive, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve, në përputhje me germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Ka deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Bilo, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Ky vendim, i arsyetuar, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 22.4.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Suela ZHEGU
Relatore

Genta Tafa (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha